



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr. Serie 03

LEJE

PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR

Nr.prot. 32 / 16 datë 07 . 12 . 2020

Miratuar me :

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR

Nr. 04, datë 27/11/2020

Emri i subjektit: **"Falcon Land"sh.p.k**

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna(NID/NIPT): **L44115803M**

Baseni Ujor: **Vjosë**

Qarku: **Vlorë**

Bashkia/Njësia Administrative: **Konispol**

Koordinatat: **X 512403.739 Y 4392201.782 Z 102 m.n.d**

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: **Për qëllime ujitje**

Prurja mesatare: **9.64 l/s**

Prurja ekologjike: **s'ka (l/s)**

Sasia e ujit që jepet në përdorim: **3.00 l/s**

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) **s'ka (l/s)**

Vendi ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet: **s'ka**

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: **Përrua lokal pa emër**

Sipërfaqja e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): **8.33 ha**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë: **Sasia e ujit që jepet në përdorim do të përdoret vetëm për qëllime ujitje. Periudha e shfrytëzimit është 60 ditë nga muaji prill deri në shtator.**

Periudha e vlefshmërisë: **5 vjet**

Hyrja në fuqi: **07.12.2020**



KRYETAR

FLAMUR MAMAJ

Kushtet e posacme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor

1. Të përdoret në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat, në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshir dhe rrjedhjen e kthyer, në një regjistër të posacëm dhe të raportoj cdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimeve ujore për hidroenergji, të instaloj një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150m poshtë cdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportoj cdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhënat dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethoj sipas projektit brezat sanitare të mbrojtjes;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengoj kryerjen e kontroleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhjen ekologjike, sipas specifikimeve në lejen apo autorizimin;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompesojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthej mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjektet për sasinë e papërdorur;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarin të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.

